



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

***UNIVERSITETI I PRISHTINËS, FAKULTETI I BUJQËSISE
DHE VETERINARISË***

RAPORT I MONITORIMIT

10.05.2023, Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

1. HYRJE

Zyrtarët përgjegjës të Agjencisë të Kosovës për Akreditim (AKA) për procedurën e monitorimit:

- *Naim Gashi, Drejtor i AKA;*
- *Arianit Krasniqi, Zyrtar i Lartë për Vlerësim dhe Akreditim, AKA;*
- *Leona Kovaci, Zyrtare e Lartë për Vlerësim dhe Monitorim, AKA.*

Data e fillimit të procedurës së monitorimit: 10.05.2023

Monitorimi është realizuar:

- a) në distancë
- b) me vizitë në terren me paralajmërim
- c) me vizitë në terren pa paralajmërim**

Data e vizitës monitoruese (nëse aplikohet): 10.05.2023

Personat me të cilët zyrtarët e AKA-së janë takuar në vizitën në terren (nëse aplikohet):

- *Iliriana Miftare, Koordinatore për cilësi në nivel të fakultetit;*
- *Salih Salihu, Prodekan për çështje mësimore.*

Burimet e informimit për raportin e monitorimit:

- *Orari i ligjëratave i publikuar në uebfaqe te fakultetit;*
- *Orari i ligjëratave i vendosur në panon e fakultetit;*
- *Intervista me profesorë/asistentë.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

2. Përshkrim i shkurtë i zhvillimit të procedurës së monitorimit për verifikimin e orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve, përfshirë të dhënat në rend kronologjik (nëse aplikohen):

Vizita monitoruese filloi në orën 10:00.

Gjate vizitës, ekipi monitorues u shoqërua nga znj. Iliriana Miftari, koordinatore për cilësi në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë. Duhet theksuar se bashkëpunimi ishte korrekt dhe znj. Miftari ishte në dispozicion për të ofruar sqarime dhe përgjigje në çdo kërkesë të ekipit monitorues.

Fillimisht u vërejt se FBV nuk ka më në dispozicion objektin kryesor ku është zhvilluar mësimi në të kaluarën dhe si rezultat, fakulteti është bartur në lokalet e shkollës së mesme (Gjimnazi i Specializuar Matematikor).

Me të arritur te objekti i shkollës së mesme, ekipi monitorues vërejt se në objekt nuk ka asnjë shenjë që tregon se ky lokacion është në dispozicion të FBV-së dhe se aty mbahen ligjëratat dhe zhvillohen aktivitete të tjera akademike.

Një gjetje tjetër ishte se orari i ligjëratave dhe ushtrimeve i publikuar në ueb faqen e fakultetit nuk ishte i njëjtë me atë që ishte prezantuar tek dyert e klasave/sallave.

Megjithatë, në objektin e gjimnazit ku mbaheshin ligjëratat e fakultetit, nga 6 sallat e monitoruara u vërejt se në 5 prej tyre mbahej mësimi në përputhje me orarin e publikuar në ueb faqe.

Në njërën nga sallat, ku mbahej provimi në lëndën “Botanikë” të programit Prodhim Bimor, u evidentua se provimi nuk mbahej nga profesori i lëndës z. Fadil Millaku, por nga asistentja znj. Resmije Millaku.

Pas përfundimit të vizitës në objektin e gjimnazit, ekipi monitorues me shoqërimin e znj. Miftari koordinatore për cilësi dhe të prodekanit për çështje mësimore z. Salih Salihu vizituan objektin e fakultetit ku janë të vendosura laboratorët.

Aty u evidentua se në:

1. laboratorin nr. 1 kishte ushtrime nga lënda “Kimi Analitike” dhe;
2. laboratorin nr. 16 asistenti Lavdim Lepaja nga departamenti Pemëtari-Vreshtari po mbante ushtrime nga lënda Baza të Pemëtarisë.

Gjatë monitorimit u vërejt se pjesa tjetër e laboratorëve nuk ishin të hapura dhe nuk ishin duke u zhvilluar ushtrime. Te laboratorët u vërejt se oraret e vendosura në dyer ishin ende të semestrit të kaluar.

Në ora 11:15 ekipi monitorues me shoqërimin e znj. Miftari vazhduan vizitën te Instituti i Bujqësisë ku u evidentua se në një kabinet mbahej lënda “Imunologji” e programit Mjekësi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agjencia Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Veterinere Viti 2 me prof. Izedin Goga dhe në kabinetin tjetër mbahej lënda “Të ushqyerit e Kafshëve 1” e programit Mjekësi Veterinere Viti 3 me prof. Fatos Krasniqi. Në institut u njoftuam se viti 4 i programit Mjekësi Veterinere ishin në fermë me prof. Behlul Behluli.

Pas përfundimit të vizitës në institut, ekipi vlerësues shfrytëzoi rastin të vizitë edhe lokacionin e fermës si dhe objektin e ri të FBV-së ku u njoftuam se për shkak të afërsisë së objektit me largpërçuesit e rrymës nuk është realizuar pranimi teknik i objektit dhe rrjedhimisht objekti është i pashfrytëzueshëm për momentin.

3. VLERËSIMI PËRFUNDIMTARË

1. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë i Universitetit të Prishtinës, në mungesë të objektit ligjëratarat dhe provimet i mbanë në hapësirat e shkollës së mesme (Gjimnazi i Specializuar Matematikor).
2. Provimi i lëndës Botanikë, programi Prodhim Bimor mbahet nga asistentja e lëndës pa prezencë të profesorit.
3. Oraret e ligjëratarave dhe ushtrimeve të shfaqura në korridor të fakultetit dhe në dyer të sallave e laboratorëve nuk përkojnë me orarin e ligjëratarave të publikuar në faqen e internetit.

4. Rekomandim

KSHC të kërkoj sqarime nga UP-FBV se a janë cenuar kushtet e akreditimit pasi që nuk janë vendosur ende në objektin e ri, por procesi mësimor mbahet nëpër objekte të shkapërderdhura.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

4. SHTOJCAT (nëse aplikohet)

- 1.
- 2.
- 3.

Zyrtarët për Vlerësim dhe Monitorim të AKA-së

Kryesues

WALIM GASHI W. Gashi 28.09.23
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Rona Kovari R. Kovari 28.09.23
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)

Anëtar

Arianit Krasniqi A. Krasniqi 28.09.23
(Emri dhe Mbiemri) (Nënshkrimi) (Data)